

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:07

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.14, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të KSHZ”, ankues TV Kopliku Malësi e Madhe.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. Ilirjan Rusmali, z.Koli Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Konservatore(z.K. Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K. Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh. Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G. Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. L. Braho: Mirëmëngjes! Çelim seancën për shqyrtimin e një sërë kërkesash ankimore. Po i relatoj unë që në fillim sepse do t’i relatojë secili nga kolegët veçmas, secilën kërkesë. Megjithatë thelbi është që sot kemi për gjykim, për seancë paraprake, në kuptim të nenit 129 të Kodit Zgjedhor verifikimin e plotësimit të formës dhe përmbajtjes së një sërë kërkesave ankimore. Fillojmë të parën me atë që është nr.14 me ankues TV Koplikun. Që të gjitha këto kërkesa ankimore kundërshtojnë vendimin nr.186 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e raporteve të tij, nga auditimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Po

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

ashtu kemi dhe dy kërkesa të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, njëra prej të cilave është kërkesa nr.3, që është “Kërkesë vendosje sanksioni administrativ” pikërisht bazuar në këtë vendimin nr. 186 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke qenë se çdo kërkesë ka bashkëlidhur një vendim dhe në vendim është cituar dhe e drejta e ankimit të palëve e të cilave janë bërë gjetjet, janë depozituar një sërë kërkesash ankimore, që ne për secilën prej tyre do vendosim në lidhje me kriteret, me elementët e formës dhe përmbajtjes. Trupa e KAS-it është e përbërë nga pesë anëtarë të saj, po ashtu është administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga z. Erdal Mema. Janë të pranishëm dhe një pjesë e palëve ankimuese të cilat do t’i pyesim rast pas rasti. Për të parën, TV Koplikun, Malësi e Madhe, ka përfaqësues?

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Me leje z. kryetar për procedurë, kjo seancë e sotme është e hapur për publikun dhe median apo jo?

Z. L. Braho: Jo, është seancë e mbyllur.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Domethënë ju keni një vendim që seanca është e mbyllur?

Z. L. Braho: Po është pa praninë e medias, është e regjistruar, me procesverbal, e ka Kodi Zgjedhor nuk është çështje vendimmarrje e jona, po kaluan për shqyrtim administrativ ajo është e hapur për median, transmetohet online. Këtu do të shqyrtojmë vetëm kërkesat, vetëm elementë të formës dhe përmbajtjes, në qoftë se do të gjykohet që këto kërkesa ankimore apo kërkesa e Komisionerit do të kalojnë për shqyrtim, seanca për shqyrtimin administrativ është e hapur për publikun.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Faleminderit i nderuar z. relator! E kisha komunikimin me kryetarin.

Z. L. Braho: Unë jam relatori dhe kryetari i kësaj seance. Tani në qoftë se ke ndonjë gjë personale me z. Rusmali thuaja pastaj.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Jo, jo jashtë e kam mik, po këtu jemi palë kundërshtare.

Z. L. Braho: Jo pra.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Po je palë kundërshtare tani.

Z. L. Braho: Po s'jemi palë kundërshtare.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Jemi palë kundërshtare në zgjedhje.

Z. L. Braho: Dëgjo tani.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Jemi në prag të zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Në qoftë se do e fillojmë kështu që në fillim.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Jo kështu do ta fillojmë në këtë, ne jemi në prag të zgjedhjeve dhe ju na sanksiononi tani pas një viti e gjysëm.

Z. L. Braho: Dëgjo, mirë pra këtë kur të vijë...

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Ky është presion politik që bëhet tani, jeni mazhorancë, PD, PS, LSI.

Z. L. Braho: Zotëri tani, dëgjo në qoftë se do të vazhdosh.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Prandaj e kisha me merak, kryetar i nderuar, s'kam asgjë personale me ju.

Z. L. Braho: Tani ti edhe s'njeh ligjin edhe do të gjesh kush është kryetari.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Mos ma trego ligjin mua se unë jam ligjvënësi, por të lutem...

Z. L. Braho: Ke qenë njëherë e një kohë.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Kam qenë, s'kam qenë atë s'e dini ju, po ushtron presion.

Z. L. Braho: Ju lutem, do të mbyllësh mikrofonin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Si thatë?

Z. L. Braho: Do mbyllësh mikrofonin tani të vazhdojmë?

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Si thatë?

Z. L. Braho: A do e mbyllësh mikrofonin?

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Jo nuk e mbyll,
kam punë me kryetarin, dua përgjigje nga kryetari.

Z. L. Braho: Kryetari!

Z. I. Rusmali: Ju lutem më lini një minutë mua, të kuptojmë qartë kush është situata që kemi sot, kjo është seancë përgatitore. Kjo seancë përgatitore nuk shqyrton thelbin e çështjes, merret vetëm me disa elementë të formës, plotësohen kushtet ligjore për ankimin apo s'plotësohen kushtet ligjore, vetëm kaq. Kur ne konstatojmë që plotësohen kushtet ligjore, pastaj ka një seancë shqyrtimi e cila është e gjitha publike dhe jepet online. Kjo seancë ka vetëm procesverbal. Procesverbal për këtë do të mbahet, regjistrohet por nuk është publike, nuk transmetohet. Seanca tjetër, kur ne do të diskutojmë thelbin e çështjes, ajo transmetohet live. Tani do të ketë vendim kjo seancë, padiskutim. Vetëm të lutem, ne e quajmë formale si seancë, kjo zakonisht mbaron me 5 minuta, kështu që të mos bëjmë debat këtu, që ta lëmë debatin, të gjitha çfarë kemi për të thënë, t'i themi kur t'i vijë radha.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Ta them një gjë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. I. Rusmali: Po patjetër.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Ta dinë zotërinjtë e tjerë, z. kryetar se Partia Kombëtare Konservatore ka marrë një takim me Komisionerin, z. Ilirjan Celibashi. Zoti Ilirjan Celibashi ka premtuar në zyrën e tij që këtë problem do ta trajtojmë pas zgjedhjeve, prandaj unë jam në këtë moment.

Z. I. Rusmali: Prandaj po them kur të vijë seanca tjetër merruni me këtë punë, mos harxhojmë kohën kot.

Z. K. Gjuzi, kryetar i Partisë Kombëtare Konservatore Albania: Faleminderit shumë edhe një herë tjetër dhe të mos më keqkuptojnë miqtë se nuk jemi armiq.

Z. L. Braho: Ka përfaqësues për TV Koplkun? S'ka, dakord. Z. Mema ju lutem në lidhje me kërkesën ankimore nr.14, që kërkon shfuqizimin e pikës 103, të vendimit nr.186, i plotëson kriteret e formës dhe përmbajtjes?

Z. E. Mema: Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126 të Kodit Zgjedhor, pika 1, gërma "b".

Z. I. Rusmali: Çfarë do të thotë kjo që ta kuptojmë të gjithë?

Z. E. Mema: Nuk ka një objekt që i referohet ankimit që kanë depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. I. Rusmali: Pse nuk ka objekt?

Z. E. Mema: Nuk kanë shënuar objektin që ankimohet, numrin e vendimit që ankimohet, një nga pikat kryesore të kërkesës ankimore.

Z. L. Braho: Dakord.

Rifillon seanca

Ora 11:34

Z. L. Braho: Mirë atëherë do të fillojmë me radhë vendimet në lidhje me kërkesën ankimore nr. 14 të TV Koplikut, KAS pasi u tërhoq për vendim, në zbatim nenit 129, shkronja “b” dhe 130, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor vendos:

Mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementëve të përcaktuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor dhe më konkretisht kompetencës së KAS-it për shqyrtimin e këtij ankimi. Duke qenë se KAS do të shqyrtojë kërkesën ankimore, kërkesën për vendosje sanksioni të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka kompetencë pikërisht për këtë kërkesë ankimore të Komisionerit dhe jo për ankime që janë bërë ndaj gjetjeve. Ankimet do të shqyrtohen si pjesë e këtij shqyrtimit administrativ të kërkesës së Komisionerit dhe të gjitha palët përfshirë këtu dhe TV Koplkun do të jetë palë e interesuar në këtë proces, ndaj për këtë arsye kjo kërkesë nuk kalon për shqyrtim vendoset mospranimi i saj.

Vendimi nr. 34

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:13

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.15 “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombëtare Konservatore Albania(z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. K. Bele: Përshëndetje! Vazhdojmë me seancën tjetër, procedurën që ta kuptoni, do marrim qëndrimin e palëve dhe në fund, duke qenë se janë 20 e ca kërkesa dhe për ekonomi do të shprehemi në fund dhe do gjejmë një zgjidhje ligjore dhe të përshtatshme. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 186, datë 08.09.2024, i KSHZ-së “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve për zgjedhjet vendore të datës 14 maj” dhe pika 2, shfuqizimin e pikës nr. 6 të vendimit marrje mase administrative për subjektin me gjobë me vlerën 500 000 lekë. Relator jam unë Koli Bele, KAS me

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

pesë anëtarë vazhdon shqyrtimin. Nga partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane kemi prezent? Nuk ka prezentë, pavarësisht mungesës shqyrtimi vazhdon. Lidhur me këtë kërkesë përfaqësuesi i KQZ-së, z. Mema, çfarë qëndrimi keni për kërkesën nëse i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes?

Z. E. Mema: Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, për këtë arsye i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. K. Bele: Mirë dhe për këtë kërkesë, nga kolegët s'ka gjë për të shtuar, dhe për këtë kërkesë do të shprehemi në mënyrë të agreguar bashkë me kërkesat e tjera. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 11:34

Z. K. Bele: Vazhdojmë me kërkesën nr.15, me të njëjtin arsyetim, për ekonomi vendosim:

Moskalimin e saj në shqyrtim me të njëjtën bazë ligjore, nenit 129 dhe nenit 130 të Kodit Zgjedhor dhe e drejta e palëve për t'u dëgjuar do të garantohet në seancën publike që do të zhvillohet për këtë qëllim.

Vendimi nr. 24

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:15

RENDI I DITËS

**Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.16 “Kundërshtimi i vendimit nr.186,
datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: zoti Vangjel
Tavo.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania(z.K.Gjuzi),
Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike
(z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli),
Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I.
Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. I. Rusmali: Nisim shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.16, për të cilën me short unë jam caktuar relator i kësaj kërkesë ankimore. Kërkesa ankimore është paraqitur nga Vangjel Tavo, në atë kohë Prefekt apo jo? Në atë kohë kandidat për kryetar bashkie i Bashkisë Himarë, aktualisht Kryetar i Bashkisë Himarë. Ka përfaqësues z.Tavo këtu? Dakord, nuk ka. Mirë, ne gjithsesi shqyrtimin paraprak e bëjmë, pavarësisht prezencës ose mungesës së subjektit të interesuar. Çfarë opinioni ka administrata lidhur me plotësimin e elementëve?

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. E. Mema: Gjithashtu dhe në këtë kërkesë i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, për këto arsye i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. I. Rusmali: Dakord. A ta bëj unë debatin tani? Dakord. Atëherë kërkesa ankimore është kundër vendimit, besoj ky arsyetim ka interes dhe për ju që jeni prezent, në qoftë se ka ndonjë gjë që s'e kuptoni, pavarësisht, mund të bëni pyetje edhe ta sqarojmë. Është kundër vendimit nr.187, datë 08.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky vendim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si të gjitha vendimet e tjera thotë "Vendosa t'i kërkoj KAS-it marrjen e masës disiplinore", kjo është lënda e vendimit, ky është objekti. Komisioneri pasi shqyrton një çështje vendos që ai t'i kërkojë KAS-it. Deri në këtë pikë, kur ai me veten e vet ka ndarë që t'i kërkojë KAS-it zhvillimin e një procedure, nuk ka lëndë ankimore për njerëzit, s'ka objekt ankimi sepse ky është, si të thuash shprehje vullneti dhe vullnetin e institucionit nuk e ndikojmë dot, kur institucioni merr vendime ndaj nesh atëherë kemi të drejtë të ankohe mi. Institucioni që çfarë ka bërë? Ka shprehur vullnetin që të vërë në lëvizje sistemin, KAS-in, sepse KAS-i ka kompetencën e vendosjes së gjobave dhe bashkë me këtë ka paraqitur dhe një kërkesë, kërkesa me nr. 4 e Komisionerit Shtetëror për, me këtë objekt "Për marrjen e masës administrative ndaj subjektit Vangjel Tavo" dhe një subjekti tjetër, drejtoreshë e shkollës së mesme të bashkuar në atë zonë. Kur vjen kërkesa në KAS, KAS-i ka detyrimin ta shqyrtojë duke i dhënë mundësinë palëve të interesuara, në rastin tim z. Tavo dhe zonjës, drejtoreshë të shkollës, që ata të jenë pjesë e procesit të shqyrtimit dhe ata të thonë, të mbajnë qëndrimin e tyre ndaj kërkesës së Komisionerit dhe procesi zhvillohet në shqyrtim të kërkesës së Komisionerit se ajo ka lëndë, ajo ka përmbajtje. Komisioneri kërkon që ne të vendosim gjobë dhe palët eventualisht do të kërkojnë që ne mos të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

vendosim gjobë. Në këtë kuptim edhe më përpara KAS-i ka thënë vendimet ku Komisioneri shpreh vullnetin nuk kanë lëndë, s'kanë objekt dhe nuk futen kërkesat ankimore ndaj tyre, nuk futen për shqyrtim në KAS sepse palët, të drejtën ligjore e ushtrojnë nëpërmjet pjesëmarrjes si palë e interesuar në shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit. E kuptoni, është e qartë kjo që po them? Pra nuk humb asnjë e drejtë e juaja që po ankoheni por thjesht, pozita juaj procedurale nuk është ajo e ankuesit se s'ka proces akoma por është ajo e palës së interesuar kur ka proces, kështu që nga kjo pikëpamje qëndrimi ynë ka qenë gjithmonë për shkak se këto ankesa janë pa objekt, vendimi nuk sjell pasoja për ju sepse vendimi i Komisionerit nuk sjell pasojë për asnjëri, vetëm për Komisionerin, që thotë “unë vendosa t'i drejtohem KAS-i”, vetëm kaq. Ne si rregull i refuzojmë këto kërkesa, për këtë shkak, këto ankesa, por kjo nuk do të thotë që ne ju heqim të drejtën se bashkë me refuzimin, ne ju themi ditën që shqyrtohet kërkesa ju jeni aty dhe mbroni të drejtat. Kjo është praktika që ne kemi ndjekur gjithmonë në këto raste, shqyrtimi bëhet në raport me kërkesën, të gjitha palët që preken nga kërkesa e Komisionerit janë automatikisht palë të interesuara për çështjen dhe kanë të drejtën e pjesëmarrjes dhe të thonë pretendimet e tyre. Këtë për shpjegim paraprak në rastin tim për Vangjel Tavon, se ai është ankuar, por që ta dini paraprakisht që kështu është për të gjithë njëloj. Gjithsesi ne do të shprehemi edhe për këtë rast do të shprehemi në fund me vendim. Në qoftë se keni ndonjë gjë? Dakord, po.

Z. E. Abazi, kryetar i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane: Tek fundi i vendimit, në pikën 105 thuhet “kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimit” ndaj e kemi bërë dhe ne ankimitin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. I. Rusmali: Dakord. Keni të drejtë por ky është një debat i brendshëm që ju në fakt nuk ju prek në asnjë lloj rrethane. E drejta juaj nuk humbet.

Z. E. Abazi, kryetar i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane: Thjesht për ta sqaruar.

Z. I. Rusmali: E drejta juaj nuk humbet, bëni apo s'bëni ankim ndaj këtij vendimi se është detyra jonë t'ju thërrasim kur shqyrtojmë kërkesën se prekim interesat.

Z. E. Abazi kryetar i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane:Duke vlerësuar këtë ne kemi bërë ankimimin.

Z. I. Rusmali: Keni të drejtë por duhet, domethënë, në qoftë se do dëgjoni për shembull që u refuzua ankimimi, mos u mërzisni se në fakt nuk ka ndodhur asgjë, thjesht po jua themi paraprakisht që ne do ju thërrasim sapo të fillojm shqyrtimin e kërkesës. Mirë e mbyllim shqyrtimin paraprak për këtë, vendimi në fund si për të gjitha të tjerat.

Rifillon seanca

Ora 11.35

Z. I. Rusmali: Edhe për kërkesën ankimore nr. 16 është i njëjti qëndrim nga ana e KAS-it, siç u shpjegua nga kolegët, kërkesa nuk pranohet për t'u marrë në shqyrtim sepse i mungon lënda, praktikisht por e drejta e subjektit do të mbrohet nëpërmjet procesit që vijon, atë të shqyrtimit të kërkesave të Komisionerit ku të gjitha subjektet

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

e prekura do të kenë të drejtën të jenë palë në proces. Mirë, mbyllim këtu shqyrtimin
paraparak për këtë kërkesë ankimore.

Vendimi nr.25

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:20

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.17, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ankues: Partia Emigracioni Shqiptar.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombëtare Konsevatore Albania (z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. I. Rusmali: Fillojmë shqyrtimin paraprak për kërkesën ankimore nr. 17 me ankues Partia e Emigracionit Shqiptar, me kryetar z. Kostaq Papa. Dakord, është prezent. Ju lutem prezantohuni.

Z. K. Papa, kryetar i Partisë së Emigracionit Shqiptar: Po, faleminderit! Kostaq Papa.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. I. Rusmali: Dakord, kryetari i Partisë së Emigracionit Shqiptar. Mirë shqyrtimi paraprak siç e thamë, në mënyrë të përsëritur ka lidhje me elementët e formës. Administrata ka ndonjë opinion lidhur me elementët e formës?

Z. E. Mema: Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126 dhe nenit 130 të Kodit Zgjedhor. I kërkojmë KAS-it kalimin e kësaj ankese.

Z. I. Rusmali: Dakord. Z. Papa keni ndonjë gjë për të thënë në raport me elementët e formës.

Z. K. Papa, kryetar i Partisë së Emigracionit Shqiptar: Jo faleminderit, unë e pashë dhe në materialin që na dërguan, disa fjalë në pika të kryesore që na kushtohen kuptohet domethënë që është ajo që thatë ju pak më parë, që ka të bëjë me gjetjen që i drejtohet Komisioneri juve dhe tjetra që është dhe ju bëni veprimin mbi në mënyrë teorike domethënë, kjo gjë kuptohet.

Z. I. Rusmali: Dakord, e qartë. Edhe për këtë kërkesë ankimore ne do të shprehemi në fund.

Rifillon seanca

Ora 11.35

Z. I. Rusmali: I njëti qëndrim është edhe për kërkesën ankimore nr. 17, me të njëtin argument ligjor edhe kjo kërkesë nuk pranohet të merret në shqyrtim, e drejta e palës, ekziston mundësia që e drejta e palës të mbrohet nëpërmjet shqyrtimit të kërkesës. E mbyllim shqyrtimin për kërkesën ankimore nr.17.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Vendimi nr. 26

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:22

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.18, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: RTV Shkodra.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania(z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. L. Braho: Vazhdojmë me kërkesën nr.18 me ankues RTV Shkodrën, ka përfaqësues? Nuk ka. Atëherë RTV Shkodra po ashtu kundërshton vendimin nr.186 të Komisionerit, kërkon shfuqizimin e pikës nr.94 të vendimit që ka të bëjë me një vendim administrativ që propozohet dhe këtij televizioni në masën 4 mijë lekë. Z. Mema në lidhje me këtë kërkesë ankimore?

Z. E. Mema: Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126 pika 1, gërma “b”,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

pra nuk referon e vendimit të Komisionerit dhe titullin, por në përmbajtje ka të bëjë me të njëjtin vendim të Komisionerit.

Z. L. Braho: Mirë dhe për këtë do të shprehemi në fund, në lidhje me vendimin.

Rifillon seanca

Ora 11.36

Z. L. Braho: Edhe për kërkesën ankimore nr. 18, me subjekt ankues Radio Televizionin Shkodra, po ashtu vendoset mospranimi i kërkesës për shkak të mungesës së kompetencës së KAS-it për të shqyrtuar këtë ankim administrativ në këtë fazë. Radio Televizioni Shkodra do të jetë pjesë e palëve të interesuara në shqyrtimin e kërkesës të Komisionerit. E mbyllim këtë seancë.

Vendimi nr. 35

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:23

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.19, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues Besnik Dushaj, kandidat për kryetar, Bashkia Tropojë.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania (z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. E. Lako: Po vazhdojmë me kërkesën ankimore nr. 19, relator jam unë Elvin Lako, z.Besnik Dushaj, kandidat për kryetar bashkie Tropojë kundërshton vendimin 186 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe konkretisht shfuqizimin e pikës 59 të vendimit. Administrata për këtë kërkesë?

Z. E. Mema: Kërkesa ankimore plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. I kërkojmë KAS kalimin e kërkesës për shqyrtim.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! dhe për këtë kërkesë do të shprehemi në fund me vendim. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 11:36

Z. E. Lako: Edhe për kërkesën nr.19, me ankues z. Besnik Dushaj KAS-i vendosi mospranimin e kërkesës për të njëjtat shkaqe ligjore u thanë më lart edhe kjo do të jetë objekt shqyrtimi i vendimarrjes së KAS-it në mbledhjet e ardhshme sipas objektit që u tha nga kolegët. Faleminderit!

Vendimi nr.27

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:24

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.20, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: Edvar Kodheli, ish kandidat për kryetar, Bashkia Fier.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania (z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. K. Bele: Vazhdojmë me kërkesën nr.20, z.Evdar Kodheli, ankimues, ish kandidat për kryetar bashkie kundërshtimin e vendimit nr. 186, të KSHZ për miratimin e raportit të gjetjeve dhe pika 2 shfuqizimi i pikës nr. 65 të vendimit ndaj të njëjtit person për vënien e gjobës me vlerën 192 mijë lekë. Përfaqësuesi, ankuesi? Nuk është prezent. Z. Mema!

Z. E. Mema: Kërkesa ankimore konstatohet se nuk i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 126/

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. K. Bele: Dakord, baza ligjore është e njëjtë, nuk ka nevojë. Pra, sipas jush nuk i plotëson.

Z. E. Mema: Për këtë arsye i kërkojmë KAS-it kthim për plotësim.

Z. K. Bele: Kthim për plotësim. Mirë. Evidentohet dhe kjo, mirë, faleminderit, shprehemi në fund dhe për këtë.

Rifillon seanca

Ora 11: 36

Z. K. Bele: Lidhur me kërkesën nr. 20, mbahet i njëti qëndrim lidhur me mosshqyrtimin e kësaj kërkesë po ashtu i njëti qëndrim mbahet për kërkesën nr. 23, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, me kaq seanca do të deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.28

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:25

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.21, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: Partia Demokratia Sociale.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania (z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. L. Braho: Mirë, atëherë kërkesa 21, me ankues Partia Demokratia Sociale, po ashtu kundërshton vendimin 186, pikën 20. Ka përfaqësues Partia Demokratia Sociale? Nuk ka përfaqësues, atëherë z. Mema në lidhje me kërkesë ankimore?

Z. E. Mema: Edhe me këtë kërkesë ankimore konstatohet se i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, për këto arsye i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. L. Braho: Edhe për këtë do të shprehem në fund. Vazhdojmë me 22.

Rifillon seanca

Ora 11:37

Z. L. Braho: Në lidhje me kërkesën ankimore nr. 21 po ashtu vendoset mospranimi i kësaj kërkesë, për shkak të mungesës së elementëve, më konkretisht të kompetencës së KQZ-së.

Vendimi nr.29

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:25

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.22, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania (z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. I. Rusmali: Për kërkesën ankimore nr.22 relator jam caktuar unë, Ilirjan Rusmali. Ka përfaqësues nga ankuesi këtu? Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian, nuk ka përfaqësues. Dakord, ne e marrim në shqyrtim pavarësisht nga ky fakt. Z. Mema të lutem!

Z. E. Mema: Kërkesa ankimore i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes dhe për këto arsye i kërkojmë kalimin e kërkesës.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. I. Rusmali: Afroje mikrofonin se nuk të dëgjojnë.

Z. E. Mema: Kërkesa ankimore i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes dhe i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. I. Rusmali: Dakord, faleminderit! Do shprehemi dhe për këtë kërkesë ankimore në fund me vendimin.

Rifillon seanca

Ora 11: 37

Z. I. Rusmali: Kërkesa ankimore nr.22 e Partisë Aleanca e Maqedonisë për Integrim Evropian në raport me këtë kërkesë KAS-i, vendos mospranimin për shqyrtim për të njëjtat arsye që i shtjelluam për të gjitha kërkesat e tjera.

Z. K. Gjuzi: Pyetja e fundit kryetar, mundem? Faleminderit! e para njëherë të faleminderit gjithë ju gjyqtarëve të KAS-it, po e kam kështu si pasion këtë, gjitha të tjerat besoj se do të jenë emblock.., domethënë ne që s'kemi bërë kërkesat për një arsye apo një tjetër, kjo ishte pyetja ime.

Z. I. Rusmali: Tani kemi një seancë ku ju mund të rrini po deshët dhe po patët kohë sepse ne fillojmë tani shqyrtimin e kërkesave të Komisionerit, dy kërkesa të Komisionerit, për të cilat ne do të caktojmë datën e shqyrtimit e caktojmë sot datën dhe ju mund ta merrni vesh tani kur dhe po sot ne do t'i japim porosinë administratës që të njoftojë të gjitha subjektet që preken nga këto kërkesa. Po qëndruat pesë minuta, se aq zgjat më shumë.

Vendimi nr. 30

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:26

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.23, “Kundërshtimi i vendimit nr.186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ankues: Partia Socialiste e Shqipërisë.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania (z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. K. Bele: Kërkesa nr. 23 Partia Socialiste e Shqipërisë, objekti është i njëjtë, shfuqizimi i vendimit nr. 38 për gjobitjen në vlerën 300 000 lekë. Lidhur me këtë kërkesë z. Mema?

Z. E. Mema: Edhe kjo kërkesë i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes dhe i kërkojmë KAS kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. K. Bele: Faleminderit! dhe për këtë do shprehemi në fund.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. I. Zhalaj, nënkryetar i Partisë Aleanca Demokristiane: Meqë ishte e fundit mund të bëj një ndërhyrje? Ne që s'kemi bërë kërkesë ankimore, e di e ezurove, po subjekti Aleanca Demokristiane, fondin nuk e ka tërhequr edhe ka ardhur kërkesa. Dakord.

Z. K. Gjuzi: Faleminderit z.kryetar e kisha për administratën. Administrata a e ka informacionin që jo të gjithë subjektet politike e kanë marrë njoftimin me shkrim?

Z. E. Mema: Po, i është dërguar të gjithë subjekteve njoftimi për seancën e KAS-it. I kemi dërguar me shkresë por disa na janë kthyer për shkak të adresave që janë ndryshuar, një pjesë i kemi dërguar me email, për ata që disponojmë.

Z. G. Apostoli: 10.11.2025? shkresa e fundit është kjo, edhe vetë u habita një çikë, thashë po e tërhoqa. Ai është lapsus, po unë për një lapsus kam marrë 1 milion gjobë, e kupton. Nga ju varet.

Z. L. Braho: Atëherë KAS do të tërhiqet 10 minuta pushim, sa për të caktuar, për të marrë vendime dhe për t'i shpallur.

Rifillon seanca

Ora 11:37

Z. K. Bele: Po ashtu i njëti qëndrim mbahet për kërkesën nr. 23, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, me kaq seanca do të deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.31

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

19.11.2024

Ora, 11:39

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.3 të KSHZ, “Për vendosje sanksioni administrativ për partinë politike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Kombetare Konsevatore Albania(z.K.Gjuzi),
Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike
(z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli),
Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane
(z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. L. Braho: Do të çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.3, datë 15.11.2024, që ka të bëjë me një kërkesë për sanksion lidhur me një vendimmarrje për miratimin të raportit të gjetjeve nga përfitimi i fondeve të shpenzuara për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në këtë vendimmarrje ndër të tjera Komisioneri ka vendosur miratimin e gjetjeve dhe ka bërë propozime për sanksione për marrjen e masës administrative për 102 subjekte, ndër të cilat ka parti politike, kandidatë për kryetar bashkie dhe një sërë mediash që janë kryesisht televizione. Për secilën prej tyre Komisioneri ka

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

propozuar marrjen e masave administrative në vlera të ndryshme. Në lidhje me këtë kërkesë administrata e KQZ-së, shkurtimisht i plotëson kriteret e formës dhe përmbajtjes?

Z. E. Mema: Kërkesa e Komisionerit me nr.3, datë 15.11.2024 i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 35 të rregullores së KAS-it, për këtë arsye i kërkojmë KAS-it kalimin për shqyrtim.

Rifillon seanca

Ora 11:42

Z. L. Braho: Mirë atëherë KAS pasi shqyrtoi kërkesën përse i përket elementëve të formës dhe përmbajtjes vendosi kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtim dhe zhvillimin e seancës së shqyrtimit administrativ në datë 03 dhjetor, ora 11.00. Administrata e KQZ-së ka detyrimin që t'i njoftojë të gjitha palët për të cilat është propozuar sanksion administrativ, pra parti politike, kandidatë, media, të gjitha të njoftohen në lidhje me zhvillimin e kësaj seance dhe kjo është edhe arsyeja se seanca u shty me datë 3, pikërisht për të bërë të mundur njoftimin e të gjithë subjekteve. Kështu që kjo seancë deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 32

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



19.11.2024

Ora, 11:42

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.4 të KSHZ, “Marrije mase administrative ndaj znj. Haide Pali dhe z. Vangjel Tavo”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, z.M.Bardhi
- **Parti Politike:** Partia Konsevatore(z.K.Gjuzi), Partia Emigracioni Shqiptar (z.K.Papa), Partia Fryma e Re Demokratike (z.Xh.Seiti), Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet(z.G.Apostoli), Partia Aleanca Demokratike (z.E. Abazi), Partia Aleanca Demokristiane (z.I. Zhalaj), Partia e Lirisë (znj. M. Dushaj)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. E. Çefa: Përshëndetje dhe njëherë, atëherë fillojmë seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 4, për vendosjen e sanksioni administrativ, sipas shortit të hedhur në KQZ, relator i kësaj kërkesë jam caktuar unë anëtari Elvis Çefa. Fillimisht verifikojmë pjesëmarrjen, është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në këtë procedurë që do të jetë?

Z. E. Mema: Erdal Mema dhe Marisold Bardhi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 19.11.2024*

Z. E. Çefa: Faleminderit! Prezent nga pala, nga subjekti i interesuar nuk ka, nga znj. Hamide Dhuli dhe z. Vangjel Tavo nuk ka, sikurse e pamë tek seanca e mëparshme z. Tavo ka paraqitur një kërkesë ankimore, e cila u vendos të mos kalohet në seancë, pikërisht vendimin mbi të cilin është bazuar kjo kërkesë e Komisionerit, por sigurisht nga administrata duhet të kujdeset që z. Tavo të njoftohet më pas. Eventualisht për caktimin, po sigurisht dhe znj. Dhuli për caktimin e datës së shqyrtimit të kësaj çështje në themel. Ia jap fjalën shkurtimisht përfaqësuesit të Komisionerit për të na sqaruar pak lidhur me opinionin e tyre për elementët e formës dhe përmbajtjes së kërkesës së Komisionerit.

Z. E. Mema: Referuar nga sa u relatua Komisioneri ka depozituar në KAS kërkesën nr. 4, datë 15.11.2024, me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ. Kërkesa i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar nenit 35 të rregullores së KAS dhe për këto arsye i kërkojmë KAS kalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë.

Rifillon seanca

Ora 11:45

Z. E. Çefa: Dakord, ju faleminderit! Atëherë KAS vendos pranimin e kërkesës dhe kalimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 4, për vendosje sanksioni administrativ, seanca e themelit për shqyrtimin e kësaj kërkesë do të zhvillohet me datë 5 dhjetor, në orën 11.30. Me kaq këtë seancë e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr.33

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

